



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.29**

**23 mars**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                            |                                                                                                                     |     |
|--------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Vendim i Kuvendit<br>nr.70, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>ministri.....                                 | 527 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.71, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>zëvendëskryeministri dhe emërim ministri..... | 527 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.72, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim<br>zëvendëskryeministri.....                       | 528 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.73, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>ministri.....                                 | 528 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.74, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim<br>ministri.....                                   | 529 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.75, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>ministri.....                                 | 529 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.76, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim<br>ministri.....                                   | 530 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.77, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>ministri.....                                 | 530 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.78, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim<br>ministri.....                                   | 531 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.79, datë 19.3.2007 | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim<br>ministri.....                                 | 531 |
| Vendim i Kuvendit                          | Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim                                                    |     |

|                                       |                                                                                                                                                                                             |     |
|---------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| nr.80, datë 19.3.2007                 | ministri.....                                                                                                                                                                               | 532 |
| Dekret nr.5223<br>datë 13.3.2007      | Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....                                                                                                                                                     | 532 |
| Vendim i KM<br>nr.114, datë 31.1.2007 | Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.....                                         | 533 |
| Vendim i KM<br>nr.116, datë 7.3.2007  | Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë .....                                                                       | 534 |
| Vendim i KM<br>nr.117, datë 7.3.2007  | Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë .....                                                                       | 535 |
| Vendim i KM<br>nr.118, datë 7.3.2007  | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Burdulliasit, në bashkinë e Beratit.....        | 535 |
| Vendim i KM<br>nr.119, datë 7.3.2007  | Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në njërin nga gjuhët e Bashkimit European | 536 |
| Urdhër METE<br>nr.151, datë 6.3.2007  | Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit.....                                                                                           | 538 |
|                                       | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Shemsije Qazim Pema                                                                                                                            | 539 |

**VENDIM**  
**Nr.70, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5226, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5226, datë 19.3.2007 për shkarkimin e zotit Aldo Bumçi nga detyra e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.71, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5227, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5227, datë 19.3.2007.

1. Për shkarkimin e zotit Ilir Rusmali nga detyra e Zëvendëskryeministrit.

2. Për emërimin e zotit Ilir Rusmali në detyrën e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.72, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5228, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5228, datë 19.3.2007 për emërimin e zotit Gazmend Oketa në detyrën e Zëvendëskryeministrit.  
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.73, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5229, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5229, datë 19.3.2007 për shkarkimin e zotit Sokol Olldashi nga detyra e Ministrit të Brendshëm.  
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.74, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5230, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5230, datë 19.3.2007 për emërimin e zotit Bujar Nishani në detyrën e Ministrit të Brendshëm.  
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.75, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5231, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5231, datë 19.3.2007 për shkarkimin e zonjës Arenca Trashani nga detyra e Ministrit të Integritetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.76, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5232, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5232, datë 19.3.2007 për emërimin e zonjës Majlinda Bregu në detyrën e Ministrit të Integritetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.77, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5233, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5233, datë 19.3.2007 për shkarkimin e zotit Maksim Cikuli nga detyra e Ministrit të Shëndetësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.78, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5234, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5234, datë 19.3.2007 për emërimin e zotit Nard Ndoka në detyrën e Ministrit të Shëndetësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.79, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5235, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5235, datë 19.3.2007 për shkarkimin e zotit Bujar Leskaj nga detyra e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.80, datë 19.3.2007**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM**  
**MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5236, datë 19.3.2007 të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5236, datë 19.3.2007 për emërimin e zotit Ylli Pango në detyrën e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET**  
**Nr.5223, datë 13.3.2007**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9, pika 7, të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Lutfi Emrush Haziri
2. Mirvete Iljas Haziri (Bajrami)
3. Këngë Lutfi Haziri
4. Lotinë Lutfi Haziri
5. Mimas Lutfi Haziri

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**  
**Nr.114, datë 31.1.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE, QË VENDOSEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE, TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 23 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Grupet, pagesat dhe përfitimet e personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike

1. Personat, si fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë e vajzat në nevojë, familjet e të cilëve nuk kanë të ardhura dhe vlerësohen se kanë nevojë për shërbime shoqërore, pranohen pa pagesë në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

2. Personat, që kanë të ardhura, si pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, kur vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike, derdhen 50 për qind të pensionit.

3. Personave, që vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij vendimi, u jepet, në dorë, një shumë në të holla, për shpenzime personale, si më poshtë vijon:

a) Fëmijëve të moshës 2-5 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 300 (treqind) lekë në muaj.

b) Fëmijëve të moshës 6-14 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1000 (një mijë) lekë në muaj.

c) Personave, që marrin shërbime në qendrat e zhvillimit, 500 (pesëqind) lekë në muaj.

ç) Personave të moshuar, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në shtëpitë rezidenciale publike, 4000 (katër mijë) lekë në muaj.

II. Shërbimet me pagesë për personat me të ardhura dhe pagesat për shërbimet shtesë, që ofrohen në institucionet rezidenciale publike

4. Personat, të cilët përveç pensionit kanë të ardhura të tjera, por kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesit shoqëror kundrejt pagesës.

5. Pagesa për këtë kategori përfituesish bëhet në masën 100 për qind të të gjitha shpenzimeve, që, mesatarisht, kryhen, për një person, i cili përfiton shërbime në institucionet e përkujdesit shoqëror. Shpenzimet për një person llogariten si mesatare për të gjitha institucionet, ku ofrohen këto shërbime, dhe përcaktohen me udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e çështjeve sociale.

6. Personat, që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror, përfitojnë edhe shërbime shtesë, shoqërore, shërbime shëndetësore të specializuara, pajisje, televizor apo frigorifer, në dhomë, kundrejt një pagese, e cila mbulon 100 për qind vlerën e këtij shërbimi. Lista e shërbimeve shtesë përcaktohet me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e çështjeve sociale.

7. Pajisjet e dhëna, që përdoren për shërbimin shtesë, nuk kthehen, kur personi largohet nga institucioni.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

9. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.116, datë 7.3.2007**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLOVENE,  
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e kalimit transit të 11 (njëmbëdhjetë) trupave dhe 4 (katër) mjeteve ushtarake slovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë–Durrës–Qafë-Thanë, në datën 14 mars 2007.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

Pika e daljes të jetë pika e kalimit kufitar në Durrës dhe pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes, trupat slovene të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.117, datë 7.3.2007**

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE,  
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 9 (nëntë) trupave dhe 3 (tre) mjeteve ushtarake italiane, në itinerarin Qafë-Thanë–Durrës, në datën 9 mars 2007.

Lejimin e kalimit transit të 9 (nëntë) trupave dhe 7 (shtatë) mjeteve ushtarake italiane në itinerarin Durrës–Qafë-Thanë, në datën 18 mars 2007.

Për trupat ushtarake, që do të kalojnë më 9 mars, pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit kufitar në Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar në

Durrës, ndërsa për trupat, që do të kalojnë më 18 mars 2007, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar në Durrës dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes trupat italiane të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.118, datë 7.3.2007**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE  
PUBLIKE TË BURDULLIASIT, NË BASHKINË E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Burdulliasit, në bashkinë e Beratit.

2. Pasuritë, pronë private, me sipërfaqe 2270 m<sup>2</sup>, që shpronësohen, si dhe pronarët përkatës, janë sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë, pronë private, të të cilëve shpronësohen, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 5 000 000 (pesë milionë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Beratit.

Ky fond u vihet në dispozicion pronarëve të shpronësuar nga bashkia brenda 3 muajve nga data e përfundimit të afatit të shpronësimit.

4. Afati i përfundimit të shpronësimit është data 15.3.2007.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Beratit.

6. Afati i përfundimit të punimeve, për objektin “Zgjerimi i varrezave publike Burdullias” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Beratit.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Beratit. Regjistrimi i ri i pasurisë 2270 m<sup>2</sup>, truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Beratit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.

8. Ngarkohet bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË BURDULLIASIT, NË BASHKINË BERAT**

| Nr. | Pronat që do të shpronësohen | Njësia e matjes | Sasia | Çmimi për njësi | Vlera në lekë | Emri i pronarit         |
|-----|------------------------------|-----------------|-------|-----------------|---------------|-------------------------|
| 1   | Truall                       | m <sup>2</sup>  | 2270  | 2200            | 5 000 000     | Feride Ibrahim Bega     |
|     | Shuma                        |                 |       |                 | 5 000 000     | Myrifete Iliaz Peshtani |

**VENDIM  
Nr.119, datë 7.3.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN NË GJUHËN SHQIPE DHE TË PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË NJËRËN NGA GJUHËT E BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria e Integritit përkthen legjislacionin e Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe legjislacionin shqiptar në njërën nga gjuhët e BE-së. Për realizimin e kësaj veprimtarie, Ministria e Integritit:

a) kryen përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit European;

b) rishikon përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, aktualisht të përkthyer nga ministritë e linjës apo institucione të tjera qendrore;

c) organizon procedurat e tenderimit, për realizimin e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të kuadrit normativ vendas në njërën nga gjuhët e BE-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik;

ç) krijon dhe përditëson bazën e të dhënave për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

d) kujdeset për respektimin e unitetit të formës dhe të terminologjisë së përkthimeve të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

dh) harton dhe boton dokumente e fjalorë të terminologjisë së specializuar, për përdorimin nga përkthyesit dhe nëpunësit civilë, të përfshirë në procesin e përkthimit të legjislacionit european në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;

e) boton dhe shpërndan kopje të legjislacionit të Bashkimit European, të përkthyer në gjuhën shqipe.

2. Ministria e Integritit, në bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, përkatësisht sipas fushës së veprimtarisë së tyre, përcakton kalendarin vjetor të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e vendeve anëtare të BE-së.

3. Ministria e Integritit përcakton përkthimin e akteve të veçanta normative vendase në njërën nga gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit European, të paparashikuara në kalendarin vjetor të përkthimit, vetëm kur akti i përkthyer kërkohet, në mënyrë specifike, nga strukturat përkatëse të Komisionit European, në zbatim të plotësimit të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Procesi i përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European kryhet nga subjekte të licencuara për kryerjen e kësaj veprimtarie, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

5. Miratimi i materialeve të përkthyer bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me propozimin e Ministrit të Integritit.

6. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë: dy ekspertë të Ministrisë së Integritit, një ekspert i ministrisë së linjës apo institucionit qendror, fusha e veprimtarisë e të cilit përputhet me fushën e veprimit të legjislacionit të Bashkimit Europian, që duhet të përkthehet, si dhe dy ekspertë të jashtëm të fushës, të caktuar nga Ministri i Integritit.

7. Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore janë të detyruara t'i vënë në dispozicion Ministrisë së Integritit bazën e të dhënave të legjislacionit të Bashkimit Europian, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar, të përkthyer në njërin nga gjuhët e BE-së.

8. Përballimi i efekteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi, parashikohet në një zë të veçantë, në buxhetin vjetor, të miratuar për Ministrinë e Integritit.

9. Ngarkohet Ministria e Integritit të nxjerrë aktet nënligjore, për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara për kryerjen e kësaj veprimtarie, tarifat e shërbimit të përkthimit, organin përgjegjës për përcaktimin e këtyre çështjeve, si dhe për funksionimin e komisionit të posaçëm.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**URDHËR**  
**Nr.151, datë 6.3.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E  
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike

a) Për Bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:

- Për qytetet e kategorisë së I (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së II (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së III (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

b) Për lojërat aritmetike që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Për lojërat e fatit sportive

a) Kategoria “Basti”, organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Kategoria “Konkurs për parashikimet sportive”, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për lotaritë

a) Lotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Lotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për çdo lotari (leje) të organizuar. Ky fond do të ç'ngurtësohet, vetëm pas përfundimit të çdo lotarie (loje).

4. Lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Licencave dhe e Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Lojërave të Fatit.

Çdo urdhër që bie ndesh këtij urdhri shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

**Genc Ruli**

### **KËRKESË**

Shtetasi Muhamed Pema, i biri i Qazimit dhe i Lirisë, i datëlindjes 1968, banues në lagjen “Shkozë” të Tiranës, kërkon shpalljen të vdekur të motrës së tij, Shemsije Qazim Pema.

KËRKUESI

**Muhamed Pema**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

|    |                                                                          |      |
|----|--------------------------------------------------------------------------|------|
| 1. | PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....                                        | 1500 |
| 2. | PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) .....                                         | 600  |
| 3. | PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... | 1300 |
| 4. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....                       | 500  |

### Botime të reja

|   |                                                                        |      |
|---|------------------------------------------------------------------------|------|
| 1 | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....            | 1000 |
| 2 | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....           | 500  |
| 3 | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....                | 1000 |
| 4 | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....               | 500  |
| 5 | PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....    | 1000 |
| 6 | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....                    | 800  |
| 7 | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....                           | 500  |
| 8 | PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... | 1000 |
| 9 | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....                  | 500  |

Hyri në shtyp më 21.3.2007  
Doli nga shtypi më 23.3.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja "Grafon"  
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë